



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 01.03.2025

Nr: 218

Ora: 12:00

VENDIM

PËR

FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË DENONCIMIN
NR. 51 ID, DATË 24.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE, TË
KOMITETIT SHQIPTAR TË HELSINKIT

Sot më datë 01.03.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

KËRKUES: Komiteti Shqiptar i Helsinkit

SUBJEKT: **Zj. Anuela Ristani**
Kryetar i deleguar për Bashkinë Tiranë

OBJEKT: Konstatimi i kryerjes së veprimtarive të ndaluara, nga neni 91 i Kodit Zgjedhor dhe neni 3, pika 3 vendimi nr. 9/2020 i Komisionit Rregullator

BAZA LIGJORE: Neni 19, pikat 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator.

KONSTATOJ:

Komiteti Shqiptar i Helsinkit më datë 24.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 51 ID.

Në këtë denoncim Komiteti Shqiptar i Helsinkit parashtrohet sa vijon:

“Bashkia Tirana ka shpallur një njoftim në faqet zyrtare të internetit të saj dhe në faqen e saj të Instagramit , nëpërmjet të cilit janë hapur aplikimet për “Mbështetje financiare (Grant) për biznese të reja të gjelbërta”. Afati i aplikimit është nga data 01.02.2025 deri në datën 31.03.2025 deri në datën 31.03.2025. Thirrja drejtohet drejt banorëve të Bashkisë Tiranë, të cilët kanë një ide për të krijuar një biznes të gjelbër apo kanë një biznes ekzistues të vogël/të mesëm të

Data: 01.03.2025

Nr: 218
Ora: 12:00



“Për fillimin e procedurës administrative bazuar në denoncimin nr. 51 ID, datë 24.02.2025, të regjistrin të denoncimeve, të Komitetit Shqiptar të Helsinkit”

regjistruar në Tiranë dhe kërkojnë të shndërrohen në biznese eco-friendly (miqësore ndaj mjedisit)..”.

Nga sa më sipër çmtoj se, ekzistojnë kushtet për t'u nisur hetimi administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pika 3, të vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

V E N D O S:

1. Fillimin e procedurës administrative ndaj:
 - Zj. Anuela Ristani, Kryetar i deleguar për Bashkinë Tiranë
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI